

Landeslease sh.a.

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

PËRMBAJTJA

FAQJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 3

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
PËRMBLEDHËSE** 4

PASQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL 5

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE 6

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 7 – 40

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtimit dhe Aksionarit të Landeslease sh.a.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Landeslease sh.a. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacioneve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rrezeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rrezeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Landeslease sh.a. më 31 dhjetor 2015 si dhe performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Landeslease sh.a. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi ato pasqyra financiare më 31 mars 2015.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
30 mars 2016
Tiranë, Shqipëri

Elvis Ziu
Elvis Ziu
Partner Angazhuar
DELOITTE AUDIT ALBANIA
Rr. Elbasanit, Pk. nr. 14/2, Pallati i Fakultetit Gjeologji-
Miniera
Tel: +355 4 45 17 920
NIP: L 41709002H TIRANA - ALBANIA

LANDESLEASE sh.a.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmblledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 (rregulluar)
Të ardhurat nga interesat	7	89,798,563	130,578,279
Shpenzime për interesa	7	<u>(22,458,929)</u>	<u>(35,294,551)</u>
Të ardhura nga interesat, neto		67,339,634	95,283,728
Të ardhurat nga komisionet, neto	8	<u>6,522,026</u>	<u>1,561,418</u>
Fitimi bruto nga aktiviteti		73,861,660	96,845,146
Shpenzime administrative	9	(21,763,593)	(29,550,385)
Shpenzime personeli	10	(19,060,290)	(21,754,236)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	15, 16	<u>(1,523,659)</u>	<u>(1,737,792)</u>
Shpenzime operative		(42,347,542)	(53,042,413)
Shpenzime të tjera operationale, neto	11	(67,130)	(5,871,322)
(Provigjoni për zhvlerësim) / rimarrje e provigjoni të qirave financiare	14	(2,961,953)	9,631,346
Zhvlerësim i aktiveve të mbajtura për shitje	17	(13,912,790)	(16,589,885)
Rimarrje / (zhvlerësim) i aktiveve të tjera		6,854,948	(1,878,710)
Humbja nga kursi i këmbimit		<u>(5,157,734)</u>	<u>(2,908,620)</u>
Fitimi para tatimit		16,269,459	26,185,542
Tatimi mbi fitimin	12	(4,552,892)	(7,478,265)
Fitimi për vitin		11,716,567	18,707,276
Të ardhura të tjera përmblledhëse		-	-
Totali i të ardhurave përmblledhëse për vitin		11,716,567	18,707,276

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmblledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Landeslease sh.a.**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015***(të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)*


	Shënime	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014 (rregulluar)
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	13	22,218,877	104,179,264
Qira financiare e arkëtueshme	14	667,490,606	631,749,211
Aktive afatgjata materiale	15	4,606,229	3,714,940
Aktive afatgjata jomateriale	16	3,535,893	3,877,381
Aktive tatimore të shtyra	22	988,188	704,277
Aktive të mbajtura për shitje	17	4,167,890	29,341,951
Aktive të tjera	18	31,712,386	5,920,030
Totali i aktiveve		734,720,069	779,487,054
Detyrimet dhe kapitali aksionar			
Kredi dhe huamarrje	19	436,375,022	281,631,519
Detyrime ndaj furnitorëve	20	26,697,467	11,002,802
Detyrime të tjera	21	4,693,824	7,615,544
Totali i detyrimeve		467,766,313	300,249,865
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	23	84,988,000	308,988,000
Primi i aksioneve		62,019,320	62,019,320
Rezerva ligjore		8,498,800	-
Fitimi i pashpërndarë		111,447,636	108,229,869
Totali i kapitalit aksionar		266,953,756	479,237,189
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		734,720,069	779,487,054

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Këshilli Mbikqyrës i Landeslease sh.a. më 30 mars 2016 dhe janë firmosur nga:


Olivera JANO
Drejtore Finance




Rezart FERZAJ
Administrator

LANDESELEASE sh.a.

Pasqyra e ndryshimit në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore	Fitim i pashpërndarë (rregulluar)	Totali
Gjendja më 1 janar 2014 (rregulluar)	308,988,000	62,019,320	-	89,522,593	460,529,913
<i>Fitimi i vitit</i>	-	-	-	20,614,328	20,614,328
<i>Rregullim i aktivitetit tatimor të shtyrë</i>	-	-	-	(1,907,052)	(1,907,052)
Fitimi i rregulluar	-	-	-	18,707,276	18,707,276
Gjendja më 31 dhjetor 2014 (rregulluar)	308,988,000	62,019,320	-	108,229,869	479,237,189
Ulje kapitali	(224,000,000)	-	-	-	(224,000,000)
Rezerva ligjore	-	-	8,498,800	(8,498,800)	-
Fitimi i vitit	-	-	-	11,716,567	11,716,567
Gjendja më 31 dhjetor 2015	84,988,000	62,019,320	8,498,800	111,447,636	266,953,756

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

LANDESLEASE sh.a.
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(të gjitha shumat janë të shprehura në LEK)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	16,269,459	26,185,542
Rregullime për:		
Provigjoni / (rimarrja) në zhvlerësimin e qirasë financiare	14 2,961,953	(9,631,346)
Zhvlerësim i aktiveve të mbajtura për shitje	17 13,912,790	16,589,885
Rimarrje / (zhvlerësim) i aktiveve të tjera	(6,854,948)	1,878,710
Shpenzimi i zhvlerësimit dhe amortizimit	15, 16 1,523,659	1,737,792
Shpenzime për interesa	7 22,458,929	35,294,551
Të ardhura nga interesat	7 (89,890,037)	(130,578,279)
Fitim nga nxjerrja e aktiveve jashtë përdorimi	78,977	25,935
Të tjera	-	(260,611)
Efekti i rivlerësimit të mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	449,450	38,781
	(39,089,768)	(58,719,040)
Ndryshim në qiranë financiare të arkëtueshme	(47,839,456)	432,725,238
Ndryshim në aktive të tjera, perfshi asetet per shitje	(10,413,265)	(31,337,481)
Ndryshim në detyrime nga klientë dhe furnitorë	15,694,665	4,084,969
Ndryshim në detyrime të tjera	(2,921,720)	7,138,296
Paraja (e përdorur në) / nga aktivitetet operative	(45,479,776)	412,611,022
Interes i arkëtuar nga qiraja financiare	96,386,479	127,115,036
Interes i arkëtuar nga depozitat afatshkurtra	91,474	260,615
Interes i paguar	(32,792,081)	(44,181,786)
Tatim fitimi i paguar	(2,099,750)	(2,160,058)
Paraja neto (e përdorur në) / nga aktivitetet operative	(22,983,422)	434,925,789
Flukset monetare në aktivitetet e investimit		
Blerje e aktiveve materiale dhe jo materiale	15, 16 (3,585,864)	(211,841)
Nxjerrje jashtë përdorimit aktive materiale dhe jo materiale	3,981,695	-
Paraja neto nga /(e përdorur) në aktivitetet e investimit	395,831	(211,841)
Flukset monetare nga aktivitetet e financimit		
Uje kapitali	(224,000,000)	
Kredi bankare të paguara	165,076,654	(577,292,663)
Paraja e përdorur në aktivitetet e financimit	(58,923,346)	(577,292,663)
Rënia neto e mjeteve monetare	(81,510,937)	(142,578,715)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	104,179,264	246,796,760
Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	(449,450)	(38,781)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	22,218,877	104,179,264

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacione të përgjithshme

Landeslease sh.a. ("Shoqëria") është e regjistruar si shoqëri anonime më 27 mars 2005 në Shqipëri sipas ligjeve në fuqi me vendimin e gjykatës nr. 33307 dhe NIPT K51629002M. Shoqëria e ka filluar aktivitetin e saj më 5 prill 2005.

Më 31 dhjetor 2015, Union Bank sh.a ("Banka") është aksionari i vetëm i Shoqërisë. Në përmbyllje të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve ("MBA"), më 22 dhjetor 2014, Banka bleu 100% të aksioneve të Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është dhënie me qira financiare e makinerive, pajisjeve të prodhimit, makinerive të lehta dhe të rënda, makinerive të specializuara për transport, etj.

Më 31 dhjetor 2015, Shoqëria ka 11 punonjës (31 dhjetor 2014: 10).

Adresa zyrtare e shoqërisë është Rr. Ismail Qemali, nr. 31, Tiranë, Shqipëri.

Këshilli Mbikqyrës

Z. Niko Leka
Zj. Majlinda Hakani
Z. Arten Zikaj

Stafi Drejtues

Z. Rezart Ferzaj – Administrator
Zj. Olivera Jano – Drejtore Finance
Z. Dorin Maraku – Drejtor i Manaxhimit të Rrezikut dhe Rikuperimit të Kredisë
Z. Besjan Avdyli – Drejtor i Shitjeve dhe Marketingut

2. Baza e Përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitura me kosto historike.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur në Lek shqiptar "Lek", e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacione mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të madh në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 5.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje. Zërat jo monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
LEK/EUR	137.28	140.14

b) Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitet ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitet ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat dhe shumat e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuara me normën e interesit efektiv.

c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifat e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për komisionet dhe tarifat që lidhen kryesisht me komisione transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që merren shërbimet.

d) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operative janë njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së saj.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

e) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zërat e kapitalit, e cila njihet direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. E ardhura e tatueshme llogaritet duke rregulluar fitimin sipas raportimit për qëllime ligjore para tatimeve për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga ligji shqiptar. Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit, të cilat pritët të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato realizohen bazuar në ligjet të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Aktivët për tatimet e shtyra njihen në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të realizohen ndaj të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivët për tatimet e shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe ulen në atë masë që nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e disa pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatime të tjera apo interesa të lidhura me to do të shfaqen si detyrim. Shoqëria beson se përlllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e ligjit të taksave dhe përvojës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet mbi vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të shfaqen mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndryshojë gjykimin e saj mbi përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrime tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën e kryrjes së këtyre përcaktimeve.

f) Aktivët dhe detyrimet financiare

i) Njohja

Shoqëria fillimisht i njeh huatë, paradhëniet dhe detyrimet e varura në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivët dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e një instrumenti. Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus (për një zë, i cili nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) kostot e transaksionit të cilat i përkasin direkt blerjes së tij ose emetimit.

ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabel 3 (g), (h), dhe (m).

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

iii) Çregjistrimi

Shoqëria ç'regjiston një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare të këtij aktivi nuk janë më të vlefshme, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukset monetare mbi aktivin nëpërmjet një transaksioni që transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia mbi aktivin financiar. Çdo interes mbi aktivet e transferuara i krijuar apo i mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv apo detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron detyrimet financiare nëse detyrimet e detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Shoqëria merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin e transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin, për shembull, huadhënien dhe riblerjen e letrave me vlerë.

Transaksionet, në të cilat Shoqëria as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e lidhur me aktivin financiar, e çregjistron aktivin nëse humbet kontrollin mbi të. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen më vete si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli, Shoqëria vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në disa transaksione, Shoqëria mban të drejtat për të marrë ose kryen shërbime për një aktiv financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar ç'regjistrohet në tërësi nëqoftëse ai i përmbush kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat për shërbimin, nëqoftëse tarifa e shërbimit është më e lart se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi (për aktivet financiare).

vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiar vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe modele vlerësimi.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vi) Matja me vlerë të drejtë (vazhdim)

Për instrumenta më komplekse, Shoqëria përdor modele të xertifikuara, që janë rrjedhojë e përmirësimeve të modele të mirënjohura. Disa ose të gjitha të dhënat e përdorura në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme dhe rrjedhin nga çmimet ose normat e tregut ose janë të vlerësuar duke u bazuar në supozime. Kur bëhet palë në një transaksion, instrumenti financiar njihet fillimisht me çmimin e transaksionit, që është edhe treguesi më i mirë i vlerës së drejtë, megjithëse vlera e përftuar nga modeli i vlerësimit mund të ndryshojë nga çmimi i transaksionit. Kjo diferencë fillestare në vlerën e drejtë e përcaktuar nga teknikat e vlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fakteve dhe rrethanave të çdo transaksioni, kur të dhënat e tregut bëhen të vëzhgueshme dhe jo më vonë.

Vlera e nxjerrë nga një model ose nga teknikat e vlerësimit rregullohet me një numër të caktuar faktorësh më të përshtatshëm, sepse teknikat e vlerësimit nuk mund të reflektojnë siç duhet të gjithë faktorët e tregut që merren parasysh në një transaksion. Rregullimet e vlerësimit përdoren për të përshtatur modelet me rrezikun, marzhin kërkesë-ofertë, rrezikun e likuiditetit si edhe faktorë të tjerë. Manaxhimi beson se këto rregullime vlerësimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme për të paraqitur me vlerë të drejtë instrumentat financiarë.

vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Shoqëria vlerëson mundësinë e zhvlerësimit të aktiveve të saj individualisht dhe në grup. Të gjitha aktivet financiare që kanë një vlerë të konsiderueshme në mënyrë individuale, testohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet e testuar individualisht dhe jo të zhvlerësuar, grupohen dhe testohen për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshëm trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Si evidencë objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshihen vonesa në pagim ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimi i termave të një huaje ose paradhënie në kushte të pafavorshme për Shoqërinë, të dhëna që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh. ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të huamarrësve ose huadhënësve të grupit ose kushte ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup, Shoqëria përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rekuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredisë janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rekuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve dhe pasqyrohen në një llogari fondi për humbjet nga zhvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimit.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje reflektohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shoqëria fshin nga bilanci ato kredi për të cilat është përcaktuar që nuk ka më asnjë mënyrë arkëtimi.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

g) Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë kartëmonedha, monedha, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Shoqëria për administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

h) Huatë dhe paradhëniet dhe qirate financiare

Huatë dhe paradhëniet dhe qiratë financiare janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Shoqëria nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Shoqëria është qiradhënësi në një kontratë qiraje ku transferohen në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mjetit tek qiramarrësi, marrëveshja paraqitet si qira financiare dhe një shumë e arkëtueshme e barabartë me investimin neto në qira njihet në hua dhe paradhënie dhënë klientëve.

Huatë dhe paradhëniet, ndryshe nga qiratë financiare të arkëtueshme, fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

i) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kostot përfshijnë shpenzime që janë drejtpërdrejtë të ngarkueshme në blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të vetë ndërtuara përfshijnë koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura. Blerja e programeve kompjuterike si pjesë integrale e funksionimit të aktivit, kapitalizohet si pjesë e këtij aktivi. Kur pjesë e aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë të aktiveve të afatgjata materiale

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin te Shoqëria, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit. Aktivitetet e marra me qira zhvlerësohen në periudhën më të shkurter midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Normat e amortizimit per periudhën aktuale dhe krahasuese janë si vijon:

Kompjuterat	25%
Mobilje dhe pajisje	20%
Pajisje zyre	20%
Makinat	25%

Metoda e amortizimit dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**j) Aktive të mbajtura për shitje**

Aktivet klasifikohen si aktive të mbajtura për shitje kur vlera mbartëse e tyre do të rikuperohet kryesisht nga një transaksion shitjeje dhe shitja konsiderohet si shumë e mundshme. Aktivet e mbajtura për shitje njihen me më të voglën midis vlerës së mbartur dhe vlerës së tregut zvogëluar me kostot e shitjes, nëse vlera mbartëse e tyre do të merret kryesisht nga një transaksion shitjeje, jo nga përdorimi i vazhdueshëm e kur shitja konsiderohet shumë e mundshme

k) Aktive jo-materiale

Programet kompjuterike të blera nga Shoqëria njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen si të tilla në periudhën që ndodhin. Shpenzimi i amortizimit njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është pesë vjet.

l) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e njohura në periudhat e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur apo nëse ekziston më si e tillë. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

m) Huatë

Huatë nga bankat maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

n) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkojnë për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

o) Garancitë financiare (vazhdim)

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Shoqërinë që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

p) Përfitimet e punonjësve

i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet sipas një plani kontributesh të përcaktuar për pensione. Kontributet për planin e pensionit që bën Shoqëria pasqyrohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

ii) Leja vjetore e paguar

Shoqëria njeh si detyrim shumë të skontuar të kostove të vlerësuar për lejen vjetore që pritët të paguhet në këmbim të periudhës së shërbimit të kryer të punonjësit.

q) Shifrat krahasuese

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015, Shoqëria ka rishikuar gjendjen e aktivitetit tatimor të shtyrë në lidhje me përlogaritjen e provigjionit për zhvlerësimin e qirasë financiare dhe aktiveve të mbajtura për shitje, duke konkluduar që nuk është e mundur të përlogaritet se sa dhe kur mund të realizohet përfitim fiskal dhe për rrjedhojë ka rregulluar pasqyrat financiare të viteve të mëparshme për shumën 10,264,274 Lek. Ky rregullim është reflektuar në rezultatin e vitit 2014 për shumën 1,907,052 Lek dhe tek fitimet e mbartura për shumën 8,357,227 Lek.

Shoqëria ka riklasifikuar nga zëri "Të ardhura neto nga komisionet" - shënimi 8 në "Shpenzime për interesa" në shënimin 7 shumën prej 159,553 Lek që lidhet me shpenzimet bankare. Gjithashtu, shumën prej 144,676 Lek për pagesat e punonjësve me kontratë shërbimi është riklasifikuar nga shënimi 10 "Shpenzime personeli" në shënimin 9 "Shpenzime administrative".

r) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar ende

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por akoma nuk ishin në fuqi:

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Vlerësimi. SNRF 9 përfshin udhëzimin e rishikuar për klasifikimin dhe vlerësimin e instrumenteve financiare, përfshirë një model të ri të humbjes së planifikuar të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit për fondin rezervë. Ky standard jep udhëzime të mëtejshme në lidhjen me njohjen dhe mos-njohjen e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2018 dhe aplikimi i mëhershëm lejohet. Shoqëria është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rezultojnë nga zbatimi i SNRF 9. Për shkak të natyrës së operacioneve të Shoqërisë, ky standard pritët të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

r) Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar ende (vazhdim)

- **SNRF 14 "Llogaritë e shtyra për qëllime rregullatore"** (Efektiv për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2016. Zbatimi i hershëm është i lejuar.)
- **SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët"** dhe ndryshime të mëtejshme (efektive duke filluar 1 janar 2018 e në vazhdim),
- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektive duke filluar 1 janar 2019 e në vazhdim),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 28 "Investime ne pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"** - Subjektet e investimeve: Përfshirje konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** - Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacionet e përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** - Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Fluksit të Parasë"** - Nisma Për Paraqitje (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të ardhurat"**, - Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e Përcaktuara (efektive për vjetore periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017)
- **Ndryshime në SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale"** - Sqarim i metodave të pranueshme të zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 41 "Agrobiznesi"** - Agrobiznes: Bimët bartesi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** - Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në disa standarde "Përmirësimet e SNRF-ve (2012-2014)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërpjethjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016).

Shoqëria ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Përveç impaktit të SNRF 9, i cili do të vlerësohet nga Shoqëria gjatë vitit 2016, Shoqëria beson se adaptimi i standarteve të reja, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të aplikimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

s) Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale

Standartet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standarteve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale.

- **Ndryshimet e SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përcaktimi i planeve të përfitimit: Kontributet e Punonjësve (efektive për periudhat që fillojnë nga data 1 qershor 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2010-2012)”** – Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standartet e ndryshme “Përmirësimet e SNRF-ve (cikli 2011-2013)”** - Ndryshime që rezultojnë nga rishikimi vjetor që u është bërë SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40), kryesisht me qëllim që të shmangen mospërputhjet dhe të qartësohet formulimi i standartit (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë nga data 1 korrik 2014).

Adaptimi i këtyre ndryshimeve tek standartet ekzistuese nuk ka çuar në ndryshime për sa i përket politikave kontabël të Shoqërisë.

4. Administrimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë.

Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut për Shoqërinë. Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar përputhjen me kufizimet. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve, standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare i Shoqërisë nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbush detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, Shoqëria konsideron të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Këshilli Mbikqyrës në bashkëpunim me Komitetin e Qirasë Financiare janë përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Shoqërisë duke përfshirë:

Formulimin e politikave të kreditimit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, procedurat dhe dokumentacionin ligjor, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve të qirasë. Limitet e aprovimit i janë shpërndarë Komitetit të Qirasë Financiare dhe Keshilli Mbikqyrës.

Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Shoqërisë në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë drejtimin në rreziqet aktuale. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston prej pesë kategorish në përputhje me rregulloren e "Administrimit të Rrezikut të Kredisë" të Bankës së Shqipërisë, të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe vlefshmërinë e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut i takon Departamentit i Riskut dhe Rikuperimit të Kredive dhe janë subjekt i monitorimit mujor.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Ekspozimi total i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë në 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 ishte si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Mjetet monetare	22,218,877	104,179,264
Qira financiare të arketueshme	667,490,606	631,749,211
Aktive të tjera	31,712,386	5,920,030
Totali	721,421,869	741,848,505

